



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 34, datë 12.05.2020

PËR
MIRATIMIN E PRISHJES SË DETYRUAR TË GODINËS SË SHKOLLËS
9-VJEÇARE “VËLLEZËRIT HARADINAJ”, RRASHBULL, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRASHBULL, DURRËS, REKOMANDUAR NGA INSTITUTI I
NDËRTIMIT, TIRANË, SI DHE HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA
PARAPRAKE E PRONAVE TË KËSAJ GODINE

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr.1003, datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr. 940, datë 30.04.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, me lëndë “Dërgim Akt ekspertizë”, ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e prishjes së detyruar të godinës, së shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Haradinaj”, që mban nr.7, të listës së transferimit dhe që me VKM nr.1003, datë 10.12.2010 është pjesë e listës parapake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Rrashbull (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 , riparimi nuk bëhet, dhe është rekomanduar të demolohet, sipas ekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake e pronave të Njesisë Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, të pronës me nr.7, të listës së transferimit, me vendodhje në Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, që i përket shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Haradinaj”, që me VKM nr.1003, datë 10.12.2010, bën pjesë në listën paraprake të Komunës Rrashbull (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Rrashbull në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me nr.7, të listës së transferimit, me vendodhje në Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull, që i përket shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Haradinaj”, që me VKM nr.1003, datë 10.12.2010, bën pjesë në listën paraprake të Komunës Rrashbull (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës, e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga institucionet përkatëse, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, që bazuar në Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese (Fondin e Zhvillimit) për të realizuar rindërtimin e godinës së shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Haradinaj”, që me VKM nr.1003, datë 10.12.2010, bën pjesë në listën paraprake të Komunës Rrashbull (sot Bashkia Durrës), të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të godinës, pas realizimit të rindërtimit.



7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme Ligjore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.05.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 427 Prot.
2

Durrës, më 13.05.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërise së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 34, datë 12.05.2020 Për miratimin e prishjes së detyruar të godinës së shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Haradinaj”, Rrashbull, njësia administrative Rrashbull, Durrës, rekomanduar nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë, si dhe heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake e pronave të kësaj godine.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

